



**Valbona Elmazi**  
Project Manager, NOA



# Erasmus for Young Entrepreneurs

Një nismë e financuar dhe e mbështetur nga Bashkimi Evropian

**#HumanFinance**

<https://noafin.al/produkte-sherbime>

Tiranë, 16 Shkurt 2024

# NOA pjesë e programit Erasmus for Young Entrepreneurs në cilësinë e Intermediary Organisation

- Nga data 01 Shkurt 2023 NOA fillon zbatimin e projektit EYE në cilësinë e Organizatës Ndërmjetëse
- Një Partneritet i përbërë nga 10 partnerë dhe 9 shtete të ndryshme si: Italia, Spanja, Bullgaria, Armenia, Letonia, Lituania, Holanda/Franca, Shqipëria dhe Turqia.
- Do të mbështesë shkëmbimin e 40 sipërmarrësve, nga të cilët 20 sipërmarrës të rinj (NE) (përfshirë edhe start-up-e) të cilët do të kryejnë një shkëmbim në një nga 45 vendet pjesë e programit dhe
- Do të presë 20 sipërmarrës nga vende të tjera të cilët do të vijnë në Shqipëri për të marrë dhe për të dhënë eksperiencën e tyre tek Sipërmarrësit Pritës (HE)
- Periudha e zbatimit të projektit 4 vite (deri në 31 Janar 2027)
- Nuk ka asnjë kufizim sektorial, pra janë të përfshirë të gjithë sektorët
- E rëndësishme është plotësimi i kriterëve administrative të aplikimit

# Çfarë është programi **Erasmus for Young Entrepreneurs**?

**Erasmus for Young Entrepreneurs** është një program shkëmbimi ndërkufitar i cili u jep sipërmarrësve të rinj dhe aspirues përfshirë edhe ata që kanë një ide novatore biznesi (NE- New Entrepreneurs – Sipërmarrësit e Rinj) mundësinë për të mësuar nga sipërmarrës me eksperiencë (HE- Host Entrepreneurs – Sipërmarrës me eksperiencë (Pritës)) dhe që drejtojnë biznese në vendet e tjera pjesëmarrëse të Bashkimit European dhe më gjërë.

Bazuar në kriteret e projektit:

- periudha e shkëmbimit dhe qëndrimit në vendin në të cilin bëhet shkëmbimi përcaktohet në një afat nga 1-6 muaj.
- nëse si aplikant keni qëndruar në një vend të caktuar më shumë se 183 ditë në 12 muajt e fundit qeheni rezident i atij vendi dhe nuk mund të bëni shkëmbimin.

Në këtë program janë të përfshira 45 shtete.

 Austria	 Albania	 Hungary	 Romania
 Belgium	 Bosnia-Herzegovina	 Ireland	 Slovakia
 Bulgaria	 Iceland	 Italy	 Slovenia
 Croatia	 Kosovo*	 Latvia	 Spain
 Cyprus	 Lichtenstein	 Lithuania	 Sweden
 Czechia	 Moldova	 Luxembourg	
 Denmark	 Montenegro	 Malta	
 Estonia	 North Macedonia	 Netherlands	
 Finland	 Norway	 Poland	
 France	 Serbia	 Portugal	
 Germany	 Türkiye		
 Greece	 Ukraine		

Shtetet si:

- Amerika,
- Kanadaja,
- Izraeli,
- Singapori,
- Taiwani dhe
- Korea e Jugut

janë pjesë e programit  
deri ne 14 Mars 2024!

# Kriteret për t'u bërë pjesë e këtij programi në cilësinë e **New Entrepreneurs(NE)**

- Të **njihni** mirë **gjuhën angleze**
- Të mos keni më shumë se **3 vite eksperience** (kumulative) në operimin e biznesit si pronar biznesi
- Të keni gati një **Jetëshkrim** (CV) në gjuhën angleze dhe në format Europass
- Të keni gati një **leter motivuese** në gjuhën angleze
- Të keni një **plan biznesi** të mirfilltë i cili duhet të pëshkruajë produktin ose shërbimin që ofroni/do të ofroni dhe i cili përmbledh objektivat operacionale, të shitjeve dhe financiare të biznesit. Gjithashtu duhet të përmbajë skema dhe buxhete të detajuara që tregojnë se si do të arrihen objektiva të tillë
- Të rregjistroheni duke aplikuar në platformën më të madhe të shkëmbimeve të bizneseve: <https://www.erasmus-entrepreneurs.eu/> dhe të plotësoni formularin e aplikimit.
- [Apply NOW!](#)

# Përfitimet për një **New Entrepreneurs (NE)**

Duke qëndruar 1-6 muaj me një sipërmarrës me eksperiencë në një vend tjetër pjesëmarrës JU:

- Fitoni njohuri kyçe për fillimin e biznesit në një gamë të gjerë sektoresh si:
  - marketing/shitjet,
  - kontabiliteti financiar,
  - marrëdhëniet me klientët,
  - financat e biznesit etj.
  - keni mundësinë të përmirësoni planin tuaj të biznesit etj.
- Ndërtimi i vetëbesimit dhe aftësive
- Aftësi teknike dhe menaxheriale;
- Mundësitë për bashkëpunim me sipërmarrës të tjerë dhe zhvillimin e bashkëpunimit të biznesit ndërkufitar;
- Rrjetëzimi dhe ndërtimi i marrëdhënieve të forta, të cilat mund të jenë të dobishme për konsultime të ndërsjella, referime biznesi dhe për gjetjen e partnerëve të biznesit jashtë vendit;
- Vështrime mbi mjedise të ndryshme kulturore dhe organizative dhe se si funksionojnë kompanitë në një vend tjetër pjesëmarrës
- Përmirësimi i aftësive gjuhësore;

# Aktivitetet dhe përgjegjësite për një **New Entrepreneurs (NE)**

Si një sipërmarrës i ri në programin Erasmus për Sipërmarrësit e Rinj, ju do të keni detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

1. Hartoni dhe nënshkruani një **"Angazhim për Cilësi"** që siguron marrëdhënie të qetë pune midis jush dhe sipërmarrësit tuaj pritës. Ndër të tjera, ai përcakton objektivat e qëndrimit dhe një plan të propozuar aktivitetesh gjatë qëndrimit;
2. Nënshkruani një marrëveshje me IO tuaj lokale për pagesën e tarifës për qëndrimin tuaj, duke specifikuar detyrat, përgjegjësitë, kushtet financiare dhe implikimet ligjore të projektit brenda afatit të rënë dakord;
3. Plotësoni një pyetësor pas qëndrimit tuaj jashtë vendit, duke përshkruar punën e kryer, aftësitë dhe njohuritë që keni marrë dhe përfitimet e shkëmbimit për zhvillimin e biznesit tuaj;
4. Kontribuoni në një qëndrim të suksesshëm dhe produktiv.

Së bashku me sipërmarrësin tuaj pritës, ju do të vendosni se cilat aktivitete do të kryeni gjatë qëndrimit tuaj dhe ato mund të përfshijnë:

1. Ndhmoni dhe punoni me sipërmarrësin tuaj pritës me eksperiencë;
2. Realizoni studime tregu dhe zhvilloni mundësi të reja të biznesi;
3. Merrni pjesë në projekte të zhvillimit të sipërmarrjes, inovacionit dhe kërkimit dhe zhvillimit;
4. Përmirësoni planin tuaj të biznesit;
5. Kuptoni financat e biznesit;
6. Zbuloni strategjitë e markës, shitjeve dhe marketingut të kompanisë së sipërmarrësit pritës.

# Kriteret për t'u bërë pjesë e këtij programi në cilësinë e

## Host Entrepreneurs (HE)

- Të jeni resident në një nga vendet pjesëmarrëse, pjesë e programit
- Të jeni të suksesshëm dhe me eksperiencë, (më shumë se 3 vjet (kumulative) aktivitet)
- Drejtoni një ndërmarrje mikro, të vogël ose të mesme ose një person i përfshirë drejtpërdrejt në sipërmarrje në nivel bordi të SME-së (jo punonjës);
- Të rregjistroheni si sipërmarrës pritës (HE – Host Entrepreneur) duke aplikuar në platformën më të madhe të shkëmbimeve të bizneseve: <https://www.erasmus-entrepreneurs.eu/>
- Të jeni të gatshëm të ndani njohuritë dhe eksperiencën tuaj me një sipërmarrës të ri dhe të veproni si mentor.
- Të keni gati një **Jetëshkrim** (CV) në gjuhën angleze dhe në format Europass
- Të **njihni** mirë **gjuhën angleze**
- Të plotësoni formularin e aplikimit në platformën IT Tool
- [Apply NOW!](#)



# Përfitimet për një **Host Entrepreneurs (HE)**

Si një **HE** që merr pjesë në program, ju do të përfitoni nga shkëmbimi duke pasur mundësinë të:

- Punoni me një sipërmarrës të ri energjik dhe të motivuar, i cili mund të kontribuojë në biznesin tuaj me pikëpamje novatore, aftësi dhe njohuri të reja;
- Përfitoni nga një "**sy i freskët**" në biznesin tuaj dhe njohuri të specializuara që mund të ketë sipërmarrësi i ri dhe që ju nuk i zotëroni;
- Veproni si trajner ose mentor;
- Mësoni për tregjet e huaja, zgjeroni mundësitë tuaja të biznesit dhe angazhohuni në aktivitete ndërkufitare;
- Ndërveproni me sipërmarrës nga vende të tjera pjesëmarrëse dhe keni mundësi për të bashkëpunuar me ta;
- Rrjetëzoheni dhe ndërtoni marrëdhënie të forta, të cilat mund të jenë të dobishme për konsultime të ndërsjella, referime biznesi dhe për gjetjen e partnerëve të biznesit jashtë vendit;
- Përmirësoni aftësitë tuaja gjuhësore;
- Nje pjese e madhe e sipërmarrësve e vlerësojnë aq shumë sa që vendosin të presin sipërmarrës të tjerë të rinj dhe disa herë!
- Nuk kërkohet asnjë tarifë aplikimi ose pjesëmarrjeje.

# Aktivitetet dhe përgjegjësite për një **Host Entrepreneurs (HE)**

Si një sipërmarrës pritës në programin Erasmus për Sipërmarrësit e Rinj, nga ju pritët të përmbushni detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

1. Ju duhet të siguroni cilësi të lartë të të mësuarit dhe bashkëpunimin e përgjithshëm sipërmarrës me sipërmarrësin tuaj të ri, i cili duhet të fitojë njohuri të mjaftueshme dhe që do ta ndihmojnë në sigurimin e një biznesi të ri dhe të qëndrueshëm;
2. Ju kërkohet të nënshkruani një dokument online "**Angazhimi për cilësi**", i cili siguron një bashkëpunim të këndshëm me sipërmarrësin e ri, ndër të tjera, përcakton objektivat e qëndrimit dhe një plan të propozuar aktivitetesh gjatë qëndrimit;
3. Ju duhet të plotësoni një pyetësor në platforme pas shkëmbimit.

# Çfarë kostosh mbulon projekti?

Janë dy mundësi :

1. Nëse dëshiron të qëndrosh 1 deri në 6 muaj jashtë Shqipërisë për të mësuar nga një biznes i huaj me eksperiencë, projekti **mbulon kostot e akomodimit, udhëtimit, dietat** etj. të cilat janë të përcaktuara nga Bashkimi Evropian dhe tarifatat varen nga vendi ku do të jetë qëndrimi.
2. Nëse je pritës i një sipërmarrësi të ri **nuk ke asnjë kosto**



Erasmus for Young  
Entrepreneurs



Erasmus for Young  
Entrepreneurs




Erasmus for Young  
Entrepreneurs

Një nismë e financuar dhe e mbështetur nga Bashkimi Evropian



Hapat/fazat në të cilat kalon një aplikim pasi behet me status “accepted” në IT Tool



## Shembuj ilustrues:

A. Ingridi ka një biznes në Shqipëri që e ka hapur para 2 vitesh. Ajo prodhon mbulesa tradicionale shqiptare. Synimi i saj është të rrisë kapacitetin prodhues dhe për këtë dëshiron të vizitojë një prodhues artizan në Itali për të mërsuar mbi teknikat e reja të rritjes së kapaciteteve prodhuese. Ajo u perzgjodh nga nisma pasi i plotësonte kriteret administrative dhe për një muaj qëndroi në Itali me të gjitha kostot e mbuluara nga projekti. Ingridi ishte në Firenze ku mësoi konkretisht nga një biznes pritës italian mbi metodat e reja. Pas kthimit në Shqipëri, Ingridi vuri në jetë mësimet e atjeshme dhe madje krijoi dhe partneritete të reja të cilat i sollën rritje të xhiros dhe të prodhimit të mbulesave të saj të cilat tani shiten dhe online.

B. Artani ka një fabrikë prodhimi vaji ulliri në Shqipëri. Ai ishte i gatshëm të priste një sipërmarrës të ri për të shkëmbyer mbi prodhimin e vajit të ullirit në Shqipëri. Një sipërmarrës nga Turqia dëshironte të mësonte më shumë mbi metodat shqiptare dhe kapacitetet e tregut të këtushëm. Ai u zgjodh dhe kaloi 2 muaj në Shqipëri pas të cilës, ai krijoi partneritet me Artanin duke bashkëpunuar në ngritjen e një sipërmarrjeje të përbashkët.

## Disa statistika për programin nga viti 2009- deri më sot



EYE: <https://www.erasmus-entrepreneurs.eu/>

Për mbështetje dhe ndihmë në lidhje me këtë program mund të kontaktoni në adresën e emailit: [velmazi@noafin.al](mailto:velmazi@noafin.al)

# FALEMINDERIT PËR VËMENDJEN!

Erasmus for Young  
**Entrepreneurs**



**Funded by  
the European Union**